

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Precedenti i rotacionit “automatik” mori fund në 2009-n
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/precedenti-i-rotacionit-automatik-mori-fund-ne-2009-n-i588997
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:44:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:39:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	16eab6e893e07cdc62c606f28d84409599a5a7bdb91eae360594eb226eda9ecd
TEKSTI	f2da0de27c459384b58ae06e4b783fa3909f0aadd6793d5203df5a381bccbe62
PAMJA	91cf188668bfdc36bacc5c75bc20d8d6f67356db7a28ebe8b54eab127c487ddb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f6ac1501060ca7f5a9da1a52f820be760f2610ebe904137c67b5b3cd1a95558e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcec101e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f6ac1501060ca7f5a9da1a52f820be760f2610ebe904137c67b5b3cd1a95558e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

 English

Built and Monetized by 

 English

ie [Precedenti i rotacionit "automatik" mori fund ne 2009-n](#) Gjermania mbeshet Gjykatën Nderkombetare Penale pas sanksioneve nga Amerika Erion Braçe shkon te vizito fundit

Precedenti i rotacionit “automatik” mori fund në 2009-n

TemA

28 Shtator 2026, 17:39 Politika TEMA



Nga Ylli Pata

Fabula e shpërndarë dje për dorëheqjen e mundshme të Edi Ramës që entuziazmojë të gjithë qarqet mediatike kundër tij, nuk është gjë e re.

Ajo hapet prej një dekate tashmë çdo tre muaj me një narrativë ndryshe të mbushur me fantazi. Disa i lidhin me zhvillime të brendshme, por shumë me ato të jashtme. Gjithkush e kujton rastin e Nepalit, Maduros apo Ramaduros, e legjendat e transferimit me helikopter e deri

Tek demonstratat me flamurin gjerman para kryeministrit.

Çështja e rotacionit të pushtetit në Shqipëri, në një situatë ku Edi Rama ka 13 vjet rresht në qeverisjeë është kthyer në një çështje frustrante për një pjesë të mirë të opinionit.

Frustrante me mjaft arsye, ngase sipas tyre nuk ka përse vijon kjo mazhorancë, vendi ka nevojë për një rotacion. Pyetja normale: rotacion te kush, përgjithësisht i bën nervozë përfaqësuesit e kësaj pjese të opinionit. “Të ikë Rama pastaj shohim e bëjmë!”, thonë pak a shumë. Që ngjan si dy pika uji me poemën e Shefqet Musarajt për Ballin Kombëtar: “Të marrim frenat, pastaj e gjejmë!”.

Megjithatë përtej këtij frustrimi që është kthyer në një ankth kolektiv i kësaj pjese të opinionit, fakt është se kjo fabul, pra rotacioni që vjen si një riciklim politik nuk është një gjë e re.

Është përdorur, madje keqpërdorur në të kaluarën, kur dhe funksionoi. Përkatesisht në vitin 2005, kur Partia Demokratike e Sali Berishës erdhi në pushtet, 8 vjet pas kataklizmosë së 1997-s.

Për të majtët, ky ishte fundi i botës, por nga ana tjetër edhe udhëheqësit politik të socialistëve e kishin keqpërdorur diskursin e gogolit.

I vetmi që e parashikoi rikthimin e Sali Berishës ishte Edi Rama, në garën e tij për kryetar të Partisë Socialiste në vitin 2003. Por, ku shkonte në mbledhjet e degëve të PS-së, socialistët e tallnin, ngase e mendonin një version parodik. Që ndodhi në të vërtetë.

Ndodhi, duhet thënë edhe si pasojë e shtytjes së disa qarqeve ndërkombëtare, të cilët e nxitën atë rotacion si një zgjidhje politike, si një lëvizje demokratike të një vendi aleat.

Por nuk kaloi shumë dhe këto qarqe e panë se kishin të bënë me një zhvillim të pakontrolluar, i cili përdorte pushtetin, duke mos pasur shumicën reale, por përdorte me metoda “pak ortodokse” ndarjen brenda së majtës. Ndërkaq Gërdeci dhe 21 janari ishin pikat që derdhën gotën. Përt ë mos përmendur armët kimike e reformën në drejtësi në 2016-n, që sollën më pas Non Gratën e 2021.

Të gjithë këto evente nuk janë tjetër veçse një kronikë e kufizuar i dështimit të aksiomës që ishte përhapur si legjendë urbane në Shqipëri që tetë vjet rri në pushtet PD e tetë vjet PS-ja.

Sot jemi përpara një realitet politik më të evoluar, alternativa!. E cila nuk ka përse të kërkojë ndarjen mes socialistëve, por votat e elektoratit në përgjithësi. Me një program, lidërsip-pra fytyrë dhe një narracion krejt të ri e të rinovuar politik.

Ndryshe, rotacioni nuk vlen, është riciklim.

TemA

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Balla takon Raporterin e PE për Shqipërinë, Andreas Schieder: Shqipëria në krye të vendeve aspirante për anëtarësim në BE

17:10 Politika

Gjekmarkaj: Ambasadori i ri i SHBA do të fusë Shqipërinë në shina

16:50 Politika

PS: Jo hartës me 100 bashki të PD! Bylykbashi: Shqyrtoni nismën tonë. Manja: Nuk ka kohë, duhet për zgjedhjet

16:40 Politika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.